

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 22 dhe nenit 20 paragrafi 1 alinetë 1 dhe 15 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e RSM” nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), nenit 15 paragrafi 1 alineja 19 dhe nenit 39 paragrafi 1 alinetë 1 dhe 15 të Rregullores për punën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (tekst i pastruar) nr. arkivor 01-3632/1 të datës 22.08.2025, dhe në përputhje me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. arkivor 02-5529/8 datë 25.12.2025, drejtori i Agjencisë, miratoi:

## **Plani vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.**

### **1. Parathënie**

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Agjencia), si një organ i pavarur rregullator që punon në mënyrë profesionale, të specializuar dhe në përputhje me standarde të larta, siguron zbatimin e qëndrueshëm të legjislacionit mediatik. Së bashku me subjektet e tjera në veprimtarinë mediatike, ajo nxit lirinë e shprehjes, lirinë e mediave, edukimin mediatik, diversitetin dhe cilësinë e përmbajtjeve mediatike që i shërbejnë interesit publik dhe nevojave të audiencës, si dhe kontribuon në zhvillimin e pandërprerë të fushës audiovizuale duke ndjekur trendet globale dhe teknologjitë më të reja në lidhje me shërbimet mediatike audiovizuale.


Duke u nisur nga fakti se korrupsioni i rrezikon të drejtat që u përkasin qytetarëve, i cenon ligjet dhe e pamundëson drejtësinë, e varfëron shoqërinë, e minon shtetin e së drejtës dhe të ardhmen e tij, është e domosdoshme që lufta kundër korrupsionit të jetë një obligim i vazhdueshëm për çdo qytetar dhe institucion.

Agjencia, me qëllim që kryesisht të veprojë në mënyrë parandaluese për uljen e rreziqeve nga korrupsioni, duke vepruar sipas detyrimit nga Ekstrakti i Procesverbalit – draft nga mbledhja e pesëdhjetë e pestë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e mbajtur më 28.06.2022, nr. 41-17/55 (nr. ynë arkivor 03-2853/1 i datës 18.07.2022), duke filluar nga viti 2022, çdo vit miraton Planin Vjetor për Vlerësimin e Rreziqeve nga Korrupsioni

(PVVRK)<sup>1</sup> të Agjencisë, i cili publikohet në faqen e saj të internetit.

---

<sup>1</sup> PVVRK i Agjencisë për vitin 2022 (nr. arkivor 03-3083/1 i datës 09.08.2022), PVVRK i Agjencisë për vitin 2023 (nr. arkivor 03-4725/1 i datës 22.12.2022) dhe PVVRK i Agjencisë për vitin 2024 (nr. arkivor 03-4730/1 i datës 22.12.2024).



Agjencia edhe në vitin 2025 do të vazhdojë të zbatojë mekanizma përmes të cilëve do të ulen rreziqet nga korrupsioni në fushat tashmë të përcaktuara si të rrezikuara brenda kompetencave dhe fushëveprimit të saj të punës, si dhe do të identifikojë rreziqe të reja dhe masa e aktiviteteve përkatëse për kontrollin dhe parandalimin e paraqitjes së korrupsionit. Në këtë drejtim, në mënyrë parandaluese dhe represive do të zbatohen mekanizma efikasë dhe funksionalë për uljen e rreziqeve nga korrupsioni, duke pasur parasysh se misioni i Agjencisë është të synojë vazhdimisht mbrojtjen dhe zhvillimin e pluralizmit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, të inkurajojë dhe mbështesë ekzistencën e shërbimeve të ndryshme, të pavarura dhe autonome mediatike audio dhe audiovizuale, si dhe të mbrojë interesat e qytetarëve në këtë fushë dhe të sigurojë transparencë në punën e radiodifuzerëve.


Ndërmarrja e aktiviteteve për parandalimin e korrupsionit nga ana e Agjencisë edhe në vitin 2025 do të shqyrtohet nga dy aspekte:

- **Aspekti i jashtëm**, përkatësisht cilat aktivitete ndërmerr Agjencia që kanë të bëjnë me mjedisin e jashtëm (jashtë Agjencisë), çfarë mund të bëjë Agjencia në nivel kombëtar në lidhje me veprimtarinë me interes publik; dhe
- **Aspekti i brendshëm**, përkatësisht cilat masa do të ndërmerren për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin nga brenda, në kuadër të vetë institucionit.


## **2. Aktivitete të realizuara dhe masa të zbatuara nga Agjencia, në përputhje me Planin e Veprimit për vitin 2024, shtojcë e Planit Vjetor për Vlerësimin e Rreziqeve nga Korrupsioni të Agjencisë për vitin 2024.**

Agjencia në vitin 2024, në përputhje me Planin e Veprimit për vitin 2024, si shtojcë e Planit Vjetor për Vlerësimin e Rreziqeve nga Korrupsioni të Agjencisë për vitin 2024, i cili përmban pasqyrë të rreziqeve, aktiviteteve, masave, bartësve/njësive organizative përgjegjëse, afateve për realizim, implikimeve financiare dhe vlerësimit të rrezikut, në kuadër të fushave ka realizuar këto aktivitete, si në vijim:


- Në fushën 1: Integriteti individual dhe institucional,
- Në lidhje me aktivitetin **Përmirësimi i integritetit personal dhe profesional dhe etikës së të punësuarve dhe personave të emëruar**, me qëllim uljen e rrezikut **Nivel i papërshtatshëm i integritetit personal dhe profesional të të punësuarve dhe personave të emëruar**, të punësuarit në Agjenci, në përputhje me pikën 4.2 të Manualit për personat për integritet, në janar të vitit 2024 nënshkruan **Deklaratë për tolerancë zero ndaj korrupsionit**, me të cilën u zotuan për respektimin e standardeve të integritetit të vendosura në Agjenci dhe promovuan angazhimin e tyre për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e zbatimit të sistemit të integritetit dhe detyrimet që rrjedhin nga mosrespektimi i këtyre standardeve, duke i respektuar dhe përmirësuar ato përmes angazhimeve të qarta. Njëkohësisht, gjatë muajit nëntor 2024, në përputhje me Aneksin 7 – Kodi Etik nga Manuali për personat për integritet, të punësuarit në Agjenci dhe pesë anëtarë të Këshillit të Agjencisë nënshkruan deklarata me të cilat konfirmohet se i kanë lexuar, kuptuar dhe do të respektojnë parimet e Kodit të sjelljes së anëtarëve të Këshillit dhe të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, si dhe mënyrën e zbatimit dhe marrjen e përgjegjësisë për zbatimin e tyre.



- Në lidhje me aktivitetin **Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe praktikave për menaxhimin e burimeve njerëzore për zhvillimin dhe avancimin e tyre profesional**, është ndërmarrë masa e përcaktuar – edukimi i të punësuarve në Agjenci përmes trajnimeve të dedikuara. Në këtë kuadër, një pjesë e të punësuarve në Agjenci (gjashtë persona) morën pjesë në 3 (tre) trajnime, si vijon: trajnim për forcimin e aftësive analitike të auditorëve; trajnim për menaxhimin e rreziqeve në sektorin publik, në kuadër të të cilit u përfshi edhe menaxhimi i burimeve njerëzore dhe rreziqet potenciale në këtë proces, si dhe monitorimi dhe realizimi i kontratave për prokurime publike dhe rreziqet potenciale në këtë proces; si dhe trajnim me temë: kontabiliteti, SNK, SNRF, analiza financiare dhe njohuritë përkatëse, tatimet dhe sistemi tatimor, njohuri organizative dhe të biznesit dhe e drejta korporative.
- Gjithashtu, të punësuarit në Agjenci gjatë vitit 2024 morën pjesë edhe në shumë punëtori dhe konferenca të lidhura me luftën kundër korrupsionit, prokurimet publike, financat, edukimin mediatik, pluralizmin mediatik, gjuhën e urrejtjes, platformat digjitale në internet, sigurinë digjitale, zgjedhjet, inteligjencën artificiale, zbatimin e detyrimeve të Agjencisë që rrjedhin nga Direktiva e rishikuar për shërbimet mediatike audiovizuale, etj.
- Në lidhje me aktivitetin **Zbatimi praktik i Udhëzimit për trajtimin e dhuratave, përfitimeve dhe mikpritjes në Agjenci**, janë ndërmarrë masat e përcaktuara – përmbushja e detyrimeve sipas Udhëzimit, mbajtja e evidencës së dhuratave të pranuar, kujdesi për pranimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre, si dhe dorëzimi i një kopjeje të listës nga evidenca në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Në këtë kuadër, brenda afatit të paraparë, nga personi i autorizuar për dhurata në Agjenci, më 13.02.2024, në KSHPK u dorëzua kopja (e pranuar në KSHPK më 14.02.2024) e Listës për evidentimin e dhuratave të pranuar – për dhuratat e pranuar gjatë vitit 2023.
- Në kuadër të masës së përcaktuar – **Vendosja e një sistemi për menaxhimin e rreziqeve nga korrupsioni**, me qëllim uljen e rrezikut të veprimit të punonjësve në kundërshtim me Strategjinë për menaxhimin e rreziqeve të Agjencisë, nga ana e ekipit për hartimin e kësaj strategjie, brenda afatit të paraparë për realizim, u realizua aktiviteti – **Hartimi i Regjistrit të rreziqeve për vitin 2024** dhe kontrolli i rregullt i statusit të rreziqeve në regjistër. Me këtë rast, më 23.12.2024 u përgatit Regjistri i rreziqeve në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, nr. arkivor 03-5222/1 i datës 23.12.2024.
  - Në fushën 2: Cilësia e punës në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale



- Në lidhje me aktivitetin **Zbatimi i qëndrueshëm i procedurave të proceseve të punës në Agjenci sipas certifikimit ISO 9001:2015**, është ndërmarrë masa e përcaktuar – verifikimi i respektimit të procedurave nga auditorët e brendshëm dhe nga auditorët e trupit të akredituar certifikues. Në këtë kuadër, në shtator 2024, të punësuarit në Agjenci – persona të autorizuar për auditim të brendshëm, realizuan auditim të brendshëm të tre procedurave interne të Agjencisë (me përzgjedhje të rastësishme).
- Një punonjës i Sektorit për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë (SMPDKA) dhe një punonjës i Sektorit për mbështetje informatike dhe punë të përgjithshme (SMIPPG) më 17.09.2024 kryen verifikimin e respektimit të procedurës ISO – **Mbikëqyrja programore dhe lëshimi i vërtetimeve për regjistrimin e paketave/shërbimeve programore**.
- Një punonjës i Sektorit për çështje strategjike dhe mbrojtje të të drejtave të autorit (SÇSMDA) dhe një punonjës i SMIPPG më 17.09.2024 kryen verifikimin e procedurës ISO – **Porositja dhe pranimi i mallrave**.
- Dy punonjës të Sektorit për çështje programore (SÇP), më 18.09.2024 kryen verifikimin e procedurës ISO – **Veprimi gjatë shqiptimit të masave dhe para gjykatave kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut**.
- Pas përfundimit të auditimeve të brendshme për tre procedurat, nga auditori kryesor – punonjës në SÇSMDA, më 19.09.2024 u përgatit **Raport kumulativ nga auditimet e brendshme të realizuara**.
- Gjithashtu, në ambientet e Agjencisë më 20.09.2024, në përputhje me Planin e auditimit, u realizua **auditim mbikëqyrës recertifikues**, me fushë certifikimi: Rregullimi i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, nga auditorët e trupit certifikues – Shoqëria për shërbime “INTERCERT” SHPKNJP Shkup, e akredituar nga Instituti për Akreditim për certifikimin e sistemeve të cilësisë. Në Raportin e auditimit nr. 03-53-R1-09/2024 të datës 26.09.2024, nuk u konstatuan mospërputhje me kërkesat e standardit ISO 9001:2015.
- Në lidhje me aktivitetin **Sigurimi i sigurisë dhe mbrojtjes së dokumenteve dhe parandalimi i qasjes së paautorizuar në to**, gjatë përdorimit të përditshëm të Sistemit për menaxhimin automatik të dokumenteve (DMS), është ndërmarrë masa e përcaktuar – mirëmbajtja e rregullt e sistemit të menaxhimit të dokumenteve (DMS). Në këtë kuadër, sistemi, për shkak të përmirësimeve teknike, është përmirësuar në disa raste gjatë vitit 2024 nga operatori ekonomik i përzgjedhur përmes prokurimit publik për mirëmbajtje preventive dhe adaptive të sistemit DMS.
- Gjithashtu, të punësuarit në të gjitha njësitë organizative të Agjencisë gjatë vitit 2024 e përdorën sistemin DMS në punën e përditshme, me ç’rast sigurohet ruajtja dhe mbrojtja e dokumenteve si dhe parandalimi i qasjes së paautorizuar në to.
- Në lidhje me aktivitetin **Zbatimi i qëndrueshëm i dispozitave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale**, janë ndërmarrë veprime në kuadër të masës së përcaktuar – verifikimi i respektimit të rregullativës ligjore nga zyrtarët e caktuar për mbrojtjen e të dhënave personale në Agjenci. Më 18.12.2024, në të gjitha njësitë organizative të Shërbimit profesional të Agjencisë u krye kontroll i përputhshmërisë së punës me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, përkatësisht u krye kontroll i autorizimeve me shkrim për përpunimin e të dhënave personale dhe i procedurës për




nënshkrimin e deklaratave për konfidencialitet dhe mbrojtje të të dhënave personale nga të punësuarit dhe personat e angazhuar në Agjenci.

➤ Në fushën 3: Trajtimi i raportimeve për parregullsi dhe raportimeve nga sinjalizuesit

- Në lidhje me aktivitetin **Rritja e ndërgjegjësimit të të punësuarve në Agjenci, drejtorit dhe anëtarëve të Këshillit për mundësitë e veprimit sipas Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe akteve nënligjore të Agjencisë**, janë ndërmarrë veprime në kuadër të masës së përcaktuar – **Përmirësimi i njohurive për ligjin e sipërpërmendur dhe Procedurën për mënyrën e trajtimit të raportimit të brendshëm të mbrojtur**. Në këtë drejtim, në faqen e internetit të Agjencisë (në një seksion të veçantë), me qëllim rritjen e dukshmërisë së procedurës për paraqitjen e raportimeve nga sinjalizuesit, janë publikuar: udhëzimet për pranimin e raportimeve nga sinjalizuesit, të dhëna për personin e autorizuar për pranimin e raportimeve, numër i veçantë telefoni, adresa elektronike për pranimin e raportimeve: ukazuvaci@avmu.mk, adresa postare për pranimin e raportimeve: rr. “Makedonija” nr. 38, Pallati “Panko Brashnarov”, Shkup, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse që rregullojnë këtë fushë, përkatësisht: Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, Udhëzimi për pranimin e raportimeve nga sinjalizuesit, ndarjen dhe përpunimin e të dhënave nga raportimet dhe masat për sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të tjera të sinjalizuesve, si dhe Rregullorja për raportimin e brendshëm të mbrojtur në institucionet e sektorit publik.
- Në lidhje me aktivitetin **Trajtimi në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, aktet nënligjore dhe Udhëzimin për pranimin dhe përpunimin e raportimeve nga sinjalizuesit**, brenda afatit të paraparë për realizim, nga personi i autorizuar për pranimin e raportimeve nga sinjalizuesit në Agjenci janë përgatitur **Raporti gjashtëmujor për raportimet e pranuar nga sinjalizuesit për gjysmën e dytë të vitit 2023** (periudha 01.07.2023 – 31.12.2023), nr. arkivor 0306-138/1 i datës 10.01.2024 dhe **Raporti gjashtëmujor për gjysmën e parë të vitit 2024** (periudha 01.01.2024 – 30.06.2024), nr. arkivor 03-3739/1 i datës 11.09.2024, të cilat janë dorëzuar në KSHPK. Gjatë këtyre periudhave nuk është paraqitur asnjë raportim nga sinjalizuesit.

Gjithashtu, është ndërmarrë masë për sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale, ku në nëntor 2024 nga SÇSMDA në Agjenci është përgatitur **Vlerësimi i ndikimit për mbrojtjen e të dhënave personale** për “Sistemin softuerik për regjistrin elektronik të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës dhe ofruesve të shërbimeve të platformave për ndarjen e videove”, nr. arkivor 03-4946/1 i datës 28.11.2024.




➤ Në fushën 4: Prokurime publike

-Në lidhje me aktivitetin **Nxitja e vazhdueshme e respektimit të legjislacionit përkatës dhe procedurave të brendshme ISO për të gjitha personat që marrin pjesë në procesin e prokurimeve publike**, me qëllim uljen e rrezikut **Planifikim i papërshtatshëm i nevojave dhe procedurave të prokurimeve publike**, janë ndërmarrë masat e përcaktuara – analiza dhe vlerësime objektive të prokurimeve publike dhe përfshirja e më shumë personave në planifikimin e tyre. Në këtë kuadër, nga të gjitha njësitë organizative në Agjenci është kryer analizë dhe vlerësim realist i vlerës së kontratave për prokurime publike të planifikuara për vitin 2024, si dhe të gjitha njësitë organizative janë përfshirë aktivisht nëpërmjet dorëzimit të propozimeve për përgatitjen e Planit vjetor të prokurimeve publike.

-Gjithashtu, në lidhje me këtë aktivitet, nga auditori i brendshëm i Shërbimit për auditim të brendshëm (SHAB) në Agjenci, në periudhën 09.01.2024 – 13.04.2024, në përputhje me Planin strategjik dhe vjetor të SHAB për vitin 2024, është realizuar auditim i procesit të prokurimeve publike për vitin 2023, pas të cilit është përgatitur **Raporti përfundimtar**, nr. arkivor 02-60/4 i datës 02.05.2024, në të cilin është konstatuar se aktivitetet kontrolluese në procesin e prokurimeve publike në Agjenci janë të përshtatshme dhe ofrojnë siguri të arsyeshme se prokurimet publike realizohen në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse. Njëkohësisht, është realizuar **verifikim recertifikues i respektimit të procedurës ISO për zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike** më 20.09.2024 nga trupi certifikues – Shoqëria për shërbime “INTERCERT” SHPKNJP Shkup, e akredituar nga Instituti për Akreditim për certifikimin e sistemeve të cilësisë. Në Raportin e verifikimit nr. 03-53-R1-09/2024 të datës 26.09.2024, nuk janë konstatuar mospërputhje me kërkesat e standardit ISO 9001:2015.

-Me qëllim uljen e rrezikut **Mungesë e kontrollit të mjaftueshëm të Agjencisë mbi zbatimin e kontratave të prokurimeve publike**, është caktuar një person përgjegjës për ndjekjen e realizimit të kontratave të prokurimeve publike, i cili ndjek zbatimin e kontratës, gjë që është futur si aktivitet i ri në Sistemin elektronik të prokurimeve publike (SEPP) nga Byroja e Prokurimeve Publike. Gjithashtu, për uljen e këtij rreziku, është zbatuar masa e përcaktuar – përfshirja më e madhe e të gjitha sektorëve në monitorimin e zbatimit të kontratave të lidhura, ku pas çdo prokurimi të realizuar dhe verifikimit të shërbimit të dorëzuar, përgatitet raport për shërbimin e kryer që konfirmon se prokurimi është realizuar sipas kritereve të tenderit, ofertës së pranuar dhe kontratës.

Po ashtu, më shumë punonjës të SFL janë përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në ndjekjen dhe realizimin e kontratave, ndërsa gjatë pranimit të mallit, punonjësi i SFL përgatit fletëpranimin që konfirmon dorëzimin e plotë të mallit sipas kërkesës dhe kontratës. Pas pagesës, një punonjës i SFL regjistron faturën përkatëse, ndërsa një tjetër



e evidenton atë në tabelë Excel në folderin “Dokumente të përbashkëta”, me qëllim mbajtjen e evidencës së pagesave dhe kontratave të realizuara.

-Gjatë vitit 2024 nuk janë raportuar përpjekje për ndikim mbi anëtarët e komisioneve të prokurimeve publike.


- Në fushën 5: Konflikti i interesit gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes
- Në lidhje me aktivitetin e përcaktuar **Ruajtja e nivelit të lartë të rezistencës ndaj korrupsionit gjatë mbikëqyrjes dhe shqiptimit të masave përmes zbatimit të qëndrueshëm të procedurave ISO, si dhe parandalimi i përpjekjeve të mundshme për ndikim ose presion gjatë mbikëqyrjes dhe shqiptimit të masave**, është realizuar masa e përcaktuar – **verifikimi periodik i respektimit të procedurave ISO gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes, sigurimit të incizimeve, shqiptimit të masave dhe përfaqësimit para gjykatave kompetente**.

Në këtë kuadër, auditorët e brendshëm ISO më 17.09.2024 kryen verifikimin e respektimit të procedurës ISO – **Mbikëqyrja programore dhe lëshimi i vërtetimeve për regjistrimin e paketave/shërbimeve programore**, ndërsa më 18.09.2024 kryen verifikimin e procedurës ISO – **Veprimi gjatë shqiptimit të masave dhe përfaqësimi para gjykatave kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut**, me ç'rast u konstatua se të dy procedurat zbatohen në mënyrë të qëndrueshme.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024 nuk janë vërejtur përpjekje për ndikim ose presion gjatë mbikëqyrjes, përkatësisht të punësuarit në sektorët përkatës që kryejnë mbikëqyrje – (SPR/SSPZAP/SIPOR/SFL) nuk kanë raportuar përpjekje për ndikim ose presion gjatë mbikëqyrjes, as nuk janë raportuar përpjekje të tilla nga të punësuarit në SPRJN në procedurat e përfaqësimit të Agjencisë para gjykatave kompetente në RMV. Për rrjedhojë, nuk ka pasur nevojë për zbatimin e Procedurës për raportimin e përpjekjeve për presion gjatë mbikëqyrjes dhe shqiptimit të masave.

- Me qëllim uljen e rrezikut **Zbatim i papërshtatshëm i legjislacionit për menaxhimin e konfliktit të interesit**, brenda afatit të paraparë është realizuar aktiviteti i përcaktuar – **hartimi i procedurës së brendshme për menaxhimin e konfliktit të interesit**. Në këtë kuadër, nga personi i caktuar për integritet dhe zëvendësi i tij është përgatitur **Procedura e brendshme për menaxhimin e konfliktit të interesit dhe raportimin e angazhimit shtesë**, nr. arkivor 02-5213/1 i datës 23.12.2024, me të cilën përcaktohen detyrimet për parandalimin e konfliktit të interesit, rrjedha e procedurës në rast ekzistence ose potenciali të konfliktit të interesit, respektimi i detyrimeve për raportim, ndalimet dhe kufizimet, përgjegjësia për mosrespektim, si dhe rregullat për raportimin e angazhimit shtesë dhe parandalimin e konfliktit të interesit.
- Gjatë vitit 2024 nuk është raportuar asnjë konflikt interesi nga të punësuarit në Agjenci.


**3. Fushat e identifikuar të ndjeshme ndaj korrupsionit brenda fushëveprimit të punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale**



Bazuar në vlerësimin e faktorëve që ndikojnë në punën e Agjencisë, si dhe për vitin 2024 dhe në Planin Vjetor për Vlerësimin e Rreziqeve nga Korrupsioni të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Agjencia) për vitin 2025, janë përcaktuar 5 fusha prioritare ku më shpesh ekziston rreziku për shfaqjen e korrupsionit:


- Integriteti individual dhe institucional;
- Cilësia e punës në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale;
- Trajtimi i raportimeve për parregullsi dhe raportimeve nga sinjalizuesit;
- Prokurimet publike dhe
- Konflikti i interesit gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes.

Përmes Planit të Veprimit për vitin 2025, i cili vijon më poshtë, do të jepet pasqyrë e rrezikut, aktiviteteve, masave, bartësve/njësive organizative përgjegjëse, afateve të realizimit, implikimeve fiskale dhe vlerësimit të rrezikut, për realizimin e aktiviteteve përmes të cilave do të mundësohet zbatimi i suksesshëm i masave të përcaktuara.




## Plani vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni i Agjencisë për vitin 2026.

4. Plani aksionar për vitin 2025						
Fusha 1: Integriteti individual dhe institucional						
Riziku	Aktiviteti	Masa	Bartës / Njësia organizative përgjegjëse	Afati i realizimit	Implikime financiare	Vlersimi i rezikut <sup>1</sup>
Nivel i pamjaftueshëm i integritetit personal dhe profesional të punonjësve dhe të emëruarve	Promovimi i integritetit dhe etikës personale dhe profesionale të punonjësve dhe të emëruarve	Vlerësime periodike të proceseve të punës për të identifikuar ndjeshmërinë e tyre ndaj korrupsionit	Kryetarët e njësive organizative/drejtorët/anëtarët e Këshillit	në gjashtë muaj	nuk ka	i kontrolluar
	Zhvillimi dhe zbatim i politikave dhe praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore për zhvillimin dhe avancimin e tyre profesional.	Edukimi i punonjësve përmes trajnimeve të synuara, me theks të veçantë tek punonjësit e sapopunësuar	Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik, duke përfshirë të gjitha njësitë organizative	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar
	Angazhimi i menaxhmentit të lartë për të krijuar një kulturë organizative të profesionalizmit, ligjshmërisë dhe intolerancës ndaj korrupsionit.		Kryetarët e njësive organizative/drejtorët/anëtarët e Këshillit	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar
	Njohja e punonjësve me elementët e sistemit të integritetit	Informimi periodik i punonjësve duke shpërndarë materiale që lidhen me elementët e sistemit të integritetit.	Persona me integritet	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar
Sjellje e punonjësve në shkelje të Kodit të Sjelljes dhe Udhëzimeve të Agjencisë për Trajtimin e Dhuratave,	Zbatimi praktik i Udhëzimeve të Agjencisë për Trajtimin e Dhuratave, Përfitimeve dhe Mikpritje	Përbushja e detyrimeve sipas Udhëzimeve	të gjitha njësitë organizative/drejtorit/anëtarët e Këshillit	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar
		Mbajtja e Regjistrave të Dhuratave të Pranuara	Sektori për Mbështetjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë (Personi i Autorizuar për Dhurata për Agjencinë)	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar
		Грижа за прием, складирање и чување на подароците		vazhdimisht		




## Plani vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni i Agjencisë për vitin 2026.

Favoreve dhe Mikpritjes		Dorëzimi i një kopjeje të listës nga të dhënat në KSPK		jo më vonë se 31 Mars 2025.		
Sjellje e punonjësve në kundërshtim me Strategjinë e Menaxhimit të Riskut të Agjencisë	Përditësimi i Regjistrimit të Risqeve për vitin 2025 dhe kontrolli i rregullt i statusit të rreziqeve në regjistër	Ngritja e një sistemi për menaxhimin e rrezikut të korrupsionit	Ekipi i krijuar me Vendim, nr. ark. 02-2074/1, datë 18.03.2015, për përgatitjen e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut të Agjencisë (Drejtuesi dhe Ndihmësdrejtori i SFL-së, të punësuar në SSPZAP dhe auditori i brendshëm në SIR)	vazhdimisht	nuk ka	pjesërisht i kontrolluar
	Zhvillimi i një Strategjie për Menaxhimin e Riskut (2025 - 2029)	Ngritja e një sistemi për menaxhimin e rrezikut të korrupsionit	Ekipi i krijuar me Vendim, nr. ark. 02-2074/1, datë 18.03.2015, për përgatitjen e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut të Agjencisë (Drejtuesi dhe Ndihmësdrejtori i SFL-së, të punësuar në SSPZAP dhe auditori i brendshëm në SIR)	gjatë vitit 2025	Nuk ka	pjesërisht i kontrolluar
<b>Fusha 2: Kualitetet e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale</b>						
<b>Riziku</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Masa</b>	<b>Bartës / Njësia organizative përgjegjëse</b>	<b>Afati i realizimit</b>	<b>Implikime financiare</b>	<b>Vlersimi i rrezikut</b>
Zbatim i papërshtatshëm i procedurave të brendshme të Agjencisë	Zbatim konsistent i procedurave të procesit të punës së Agjencisë në përputhje me certifikimin ISO 9001:2015	Verifikimi i përputhshmërisë me procedurat nga auditorët e brendshëm dhe auditorët e një organi certifikimi të akredituar	Persona të autorizuar për verifikim të brendshëm  Persona të autorizuar nga një organ certifikimi i akredituar	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar
	Sigurimi i sigurisë dhe mbrojtjes së dokumenteve dhe parandalimi i aksesit të paautorizuar në to, gjatë përdorimit të përditshëm të Sistemit të Automatizuar të Menaxhimit të Dokumenteve (DMS)	Mirëmbajtje e rregullt e sistemit të menaxhimit të dokumenteve	Sektori për Mbështetjen e Informatike dhe Çështjet e Përgjithshme Departamenti për Mbështetjen e Informatike dhe Teknologjitë të gjitha njësitë organizative/drejtor/kryetar i Këshillit	vazhdimisht	ka	i kontrolluar




Plani vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni i Agjencisë për vitin 2026.

Zbatim i papërshtatshëm i rregulloreve ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale	Zbatimi konsistent i rregulloreve ligjore që rregullojnë këtë çështje	Verifikimi i përputhshmërisë me rregulloret ligjore nga zyrtarët e emëruar të mbrojtjes së të dhënave personale në Agjenci	Zyrtarët e emëruar të mbrojtjes së të dhënave personale në Agjenci	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar
		Përmirësimi i njohurive të të gjithë punonjësve në Agjenci rreth rregulloreve ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, përmes ndarjes së materialeve nga trajnimet e ndjekura nga zyrtarët e caktuar.	Zyrtarët e emëruar të mbrojtjes së të dhënave personale në Agjenci	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar
<b>Fusha 3: Trajtimi i raporteve të parregullsisë dhe raporteve nga sinjalizuesit</b>						
<b>Riziku</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Masa</b>	<b>Bartës / Njësia organizative përgjegjëse</b>	<b>Afati i realizimit</b>	<b>Implikime financiare</b>	<b>Vlersimi i rezikut</b>
Zbatim joadekuat i legjislacionit dhe sistemit të mbrojtjes së sinjalizuesve	Rritja e ndërgjegjësimit midis punonjësve të Agjencisë, drejtorit dhe anëtarëve të Këshillit rreth mundësive për të vepruar sipas Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe rregulloreve të Agjencisë.	Përmirësimi i njohurive rreth Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Procedurës për Procedurën e Raportimit të Brendshëm të Mbrojtur, përmes depërtimit në aktet ligjore dhe nënligjore të disponueshme në faqen e internetit të Agjencisë.	Personi përgjegjës për marrjen e raporteve nga sinjalizuesit	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar




## Plani vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni i Agjencisë për vitin 2026.

	Duke vepruar në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, aktet nënligjore, Udhëzimet për Pranimin e Raportimeve nga Sinjalizuesit, Nxjerrjen dhe përpunimin e të dhënave nga raportimet dhe marrjen e masave për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave të tjera të Agjencisë.	Përgatitja e një raporti gjysmëvjetor mbi trajtimin e raporteve të sinjalizuesve për gjysmën e dytë të vitit 2024 dhe gjysmën e parë të vitit 2025.		Janar 2025/ Gusht 2025/	nuk ka	i kontrolluar
<b>Fusha 4: Prokurime publike</b>						
<i>Riziku</i>	<i>Aktiviteti</i>	<i>Masa</i>	<i>Bartës / Njësia organizative përgjegjëse</i>	<i>Afati i realizimit</i>	<i>Implikime financiare</i>	<i>Vlersimi i rezikut</i>
Planifikim joadekuat i nevojave dhe procedurave të prokurimit publik	Inkurajimi i qëndrueshmërisë së vazhdueshme në përputhje me legjislacionin përkatës dhe procedurat e brendshme ISO për të gjithë personat që marrin pjesë në procesin e prokurimit publik.	Analiza dhe vlerësime objektive të prokurimit publik Përfshirja e shumë personave në planifikimin e prokurimit publik	Të gjitha njësitë organizative në Shërbimin Profesional të Agjencisë	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar
Kontroll i pamjaftueshëm i Agjencisë mbi zbatimin e kontratave të prokurimit publik	Përfshirje më e madhe e të gjithë sektorëve në monitorimin e zbatimit të kontratave të lidhura të prokurimit publik, brenda juridiksionit të tyre, duke emëruar persona për të monitoruar zbatimin e kontratave.	Raportet mbi shërbimet e kryera/mallrat e dorëzuara nga njësia organizative kompetente	Sektori i Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik, Departamenti i Prokurimit Publik  Të gjitha njësitë organizative në Shërbimin Profesional të Agjencisë	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar
Konflikti i interesit	Raportimi i një konflikti të mundshëm interesi	Verifikimi i procedurës në rast të një konflikti interesi të raportuar/zëvendësimi të pjesëmarrësit në	Sektori për Çështje Juridike dhe Prokurim Publik, Departamenti i Prokurimit Publik  Personat e përfshirë në procedurat e prokurimit publik	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar



## Plani vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni i Agjencisë për vitin 2026.

		procesin e prokurimit publik				
Përpjekje për të ndikuar në procedurat e prokurimit publik	Raportimi i një përpjekjeje për të ndikuar te anëtarët e Komisioneve të Prokurimit Publik	Sigurimi i mbrojtjes së duhur për sinjalizuesit në përputhje me procedurat e përcaktuara brenda Agjencisë	Të gjitha njësitë organizative në Shërbimin Profesional/Drejtori/Anëtarët e Këshillit të Agjencisë	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar
<b>Fusha 5: Konflikti i interesit në kryerjen e mbikëqyrjes</b>						
<b>Riziku</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Masa</b>	<b>Bartës / Njësia organizative përgjegjëse</b>	<b>Afati i realizimit</b>	<b>Implikime financiare</b>	<b>Vlersimi i rezikut</b>
Sistem i papërshtatshëm i krijuar për rezistencë ndaj korrupsionit	Ruajtja e një niveli të lartë rezistence ndaj korrupsionit në mbikëqyrje dhe zbatim përmes zbatimit të vazhdueshëm të procedurave ISO.	Периодична проверка на почитувањето на ИСО процедурите при вршење надзор; обезбедување снимки; изрекување мерки и застапување пред надлежните судови	Сите организациони единици кои вршат надзор/ одат на застапување пред надлежните судови/ директор/ членови на Совет  Лице за заштита на укажувачи  Интерни ИСО проверувачи	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar
	Parandalimi i përpjekjeve të mundshme për ndikim ose presion në mbikëqyrje, vendosja e masave dhe kryerja e auditimeve të brendshme. Vazhdimisht ruajtja e një niveli të lartë rezistence ndaj korrupsionit në mbikëqyrje dhe vendosja e masave përmes zbatimit të vazhdueshëm të procedurave ISO.	Refuzimi i një urdhri për veprim në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret e Agjencisë  Ofrimi i mbrojtjes së duhur për sinjalizuesit/punonjësit që kanë refuzuar me të drejtë një urdhër	Të gjitha njësitë organizative brenda Agjencisë që kryejnë mbikëqyrje  Shërbimi i Auditimit të Brendshëm Zyrtari i Mbrojtjes së Informatorëve Organizimi sindikal i Agjencisë	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar



## Plani vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni i Agjencisë për vitin 2026.

Zbatimi i papërshtatshëm i legjislacionit për menaxhimin e konflikteve të interesit	Duke vepruar sipas Procedurës së Agjencisë për Menaxhimin e Konfliktit të Interesit	Raportimi i një konflikti interesi nga punonjësit e Agjencisë	Të gjitha njësitë organizative në Shërbimin Profesional/Drejtor/Anëtarët e Këshillit të Agjencisë	vazhdimisht	nuk ka	i kontrolluar
---	---	---	---	-------------	--------	---------------

**Agjencia për Shërbime  
Mediatike Audio dhe Audiovizuale**

**Drejtore,  
dr. Zoran Trajçevski**

**Dorëzuar te:**

- Të gjitha njësitë organizative brenda Agjencisë dhe
- Sektori për Mbështetje Informativë dhe Çështje të Përgjithshme – Arkivi i Agjencisë